



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1. pikën b) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Gjeokonsult&Co” Sh.P.K. të datës 14.03.2023 kundër dokumentit të parakualifikimit të datës 21.07.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës sipas përshkrimit teknik” me nr. të prokurimit 616-22-7431-3-1-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 108 312, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Gjeokonsult&Co” Sh.P.K. e datës 14.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës sipas përshkrimit teknik” me nr. të prokurimit 616-22-7431-3-1-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 108 312.
- II. **VERTETOHET** Njoftimi mbi rezultatet e pjesës teknike të publikuara nga AK me datën: 09/03/2023
- III. **AUTORITETI KONTRAKTUES** – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Gjeokonsult&Co” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Operatori ekonomik "Gjeokonsult&Co" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 14.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër dokumentit të parakualifikimit të datës 21.07.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës sipas përshkrimit teknik" me nr. të prokurimit 616-22-7431-3-1-2 dhe nr. të brendshëm 616 22 108 312.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka gjetur se kërkesa e parashtruesit nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në nenin 62.1. paragrafin b) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"). Aktiviteti i prokurimit për të cilin po bëhet fjalë, është zhvilluar si kontratë kornizë me procedurë të kufizuar në dy (2) faza (ky fakt nuk është kontestuar asnjëherë nga parashtruesi). Megjithatë kërkesa për rishqyrtim së bashku me pretendimet e parashtruesit i referohen vetëm fazës së parë të kësaj procedure e cila ka të bëjë me dokumentin e parakualifikimit të publikuar me datë 21.07.2022. Këto pretendimet është dashur të parashtrohen brenda afatit të përcaktuar për kërkesë për rishqyrtim para se të përfundoj faza e parë me datë 29.11.2022 dhe jo tani. Përmes nenit 47.1. paragrafit a) të RRPP kjo fazë njihet si faza e parakualifikimit dhe është klasifikuar si fazë e mëvetësishme (e pavarur) në kuadër të procedurës. Në rastin konkret kjo fazë ka përfunduar me datë 29.11.2022 ku edhe janë publikuar rezultatet e parakualifikimit. Rrjedhimisht kërkesa e parashtruesit e datës 14.03.2023 ka arritur rreth tre (3) muaj e gjysmë pas përfundimit të kësaj faze. Në këtë kuptim kërkesa e parashtruesit është e palejuar në kuptim të nenit 62.1. paragrafit b) të RRPP.

Bazuar në nenin 62 paragrafin 62.1. nënparagrafin b) të RRPP përcaktohet si në vijim "Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në nenin 59.1 të kësaj rregullore".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa e parashtruesit është refuzuar pa shqyrtim *in meritum* të pretendimeve të parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nënparagrafit b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. pikën a) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.03.2023

  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.